


Nuk ka diplomë pa lidhje: Informacion për prindër "KAoA-kompakt"

Të dashur prindër, të dashur kujdestarë ligjorë,

për një të ardhme të sigurt, ku fëmija juaj mund ta fitojë vetë financimin e jetë tij, rëndësi të veçantë ka një orientim i suksesshëm i profesionit dhe studimit, si dhe zgjedhja vijuese e profesionit. Në shkollat e Nordrhein-Westfalen-it (Vestfalia e Rinit Verior) orientimi i profesionit dhe studimit është një pjesë përbërëse e mësimit në kuadër të projektit të landit "Kein Abschluss ohne Anschluss" (KAoA). (Nuk ka diplomë pa lidhje). Kalimi nga shkolla në profesion po përmirësohet sistematikisht në shkollat e landit Nordrhein-Westfalen me pjesëmarrjen e ministrive, komunave, sektorit ekonomik, sindikatave dhe Zyrës Federale të Punësimit (Bundesagentur für Arbeit) (për më shumë: "Filmi shpjegues i KAoA" në www.berufsorientierung-nrw.de).

Të rinjtë që kanë migruar kohët e fundit dhe që po marrin mësim në kolegjet profesionale në klasat ndërkombëtare mbështetëse ose në klasën e 10-të të një shkolle të përgjithshme, mund të marrin pjesë në "KAoA-kompakt". Kjo masë i mbështet ata gjatë zgjedhjes së një formimi profesional ose të një dege studimi dhe përbëhet nga komponentët e mëposhtëm që zhvillohen në këtë vit akademik:



Para dhe pas çdo komponenti fëmija juaj do të marrë konsulencë në shkollë. Kjo konsulencë është pjesë e pandashme e programit KAoA dhe ofrohet nga ofruesi i trajnimit, i cili kryen analizën potenciale, eksplorimet e fushave të profesionit dhe kursin e praktikës.

Analiza e potencialit është komponenti i parë i procesit të përzgjedhjes së profesionit për fëmijën tuaj dhe ju jep informacion në lidhje me pikat e forta dhe mundësitë e zhvillimit. Ajo ia bën më të lehtë atij që gjatë procesit të mëtejshëm të orientimit të profesionit të eksplorojë fushat e përshtatshme të profesionit dhe të kërkojë vendet e praktikës.

Pikat e forta dhe potencialet e fëmijës suaj vëzhgohen edhe gjatë eksplorimeve të fushave të profesionit dhe gjatë trajnimit praktik. Rezultatet e vëzhgimeve do t'u bëhen të ditura të rinjve dhe do t'i ndihmojnë në marrjen e vendimit se cili profesion u intereson dhe cilat rrugë formimi profesional planifikojnë.

Rezultatet e vëzhgimeve përdoren në shkollë vetëm për t'i mbështetur të rinjtë në procesin e mëtejshëm të orientimit nëpërmjet bisedave të konsulencës. Ato nuk ruhen, nuk transferohen më tej dhe nuk përdoren për qëllime të tjera.

Ato nuk përfshihen në vlerësimin e notave dhe nuk kanë asnjë ndikim në statusin e lejes së qëndrimit.

Në raste të veçanta mund të ndodhë që punonjës të zyrave komunale të koordinimit ose administrata e shkollës të kryejnë vizita në formën e marrjeve të kampioneve. Këto mikpritje i shërbejnë vetëm qëllimit për të siguruar cilësinë e programit KAoA. Ato kontrollojnë vetëm mënyrën se si zbatohet kjo masë në mënyrë organizative nga ana e ofruesve të trajnimit. Pas njoftimeve paraprake mund të ndodhë që të ketë edhe mikpritje të personelit shkencor shoqëruar për të vlerësuar masën KAoA. Edhe këtyre punonjësve u lejohet të marrin të dhëna personale nga të rinjtë pjesëmarrës.

Në mënyrë që ofruesit e caktuar të jenë në gjendje që ta përlllogarisin kë të masë, krijohen lista nënshkrimet në të cilat duhet të futet mbiemri, emri, seksi dhe datëlindja e të rinjve pjesëmarrës. Ofruesit kanë detyrimin që t'i përdorin të dhënat e ruajtura vetëm për përlllogaritje të masës me "Landes-Gewerbeförderungsstelle des nordrhein-westfälischen Handwerks e.V. (LGH)" (Instituti i mbështetjes së industrisë të profesioneve të specializuara të landit Nordrhein-Westfalen). Pas përlllogaritjes, te ofruesi nuk mbetet më asnjë e dhënë personale e të rinjve

Grumbullimi i të dhënave nga ofruesi mund të ndodhë vetëm me pëlqimin e fëmijëve tuaj. Ky pëlqim mund të anulohet në çdo kohë. Anulimi për këtë duhet të përmbajë një sqarim kundrejt shkollës. Nëse të rinjtë nuk e japin pëlqimin, atëherë ata marrin pjesë në një ofertë tjetër për orientimin e profesionit.